



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 150, datë 31.08.2023

**PËR
MIRATIMIN E SHOQËRISË “NEXIA AL” SH.P.K., SI SHOQËRI AUDITUESE PËR
AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE
“ALBSIG INVEST” SH.A., SI DHE TË FONDEVE QË ADMINISTRROHEN PREJ SAJ,
PËR VITIN FINANCIAR QË MBYLLET MË 31.12.2023**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 33 të ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, si dhe nenit 35, të ligjit nr. 56, datë 30.04.2020 Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe të rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e shoqërisë “Nexia AL” sh.p.k., si shoqëri audituese për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë administruese “Albsig Invest” sh.a., si dhe të fondeve që administrohen prej saj, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2023.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**